

KULTIVIMI I GJUHËS SHQIPE NË RADIO VATIKAN (MBI 70 VJET PROGRAM SHQIP NË RADIO VATIKAN)

Engjëll KOLIQI

Përmbledhje

Që nga data 3 tetor 1951, pra mbi 70 vite, gjuha jonë kultivohet në Radio Vatikan. I pari që foli shqip përmes valëve të Radio Vatikanit, ishte Imzot Zef Shestani. Në fillim emisionet e gjuhës shqipe në Radio Vatikan qenë transmetuar në dialektin e gegnishtes, për t'u përzier dialektet tona aty që nga pranvera e vitit 1990 e për t'u bërë më vonë me normën letrare të gjuhës sonë të njësuar. Kronika e parë në normën e njësuar letrare u transmetua në prill 1990 nga autori i këtij shkrimi, edhe të ligjëruar në Festivalin e Imazhit Shqiptar 2021, Engjëll Koliqi. Pra, njëri nga kultivuesit e normës së njësuar letrare të gjuhës sonë në Radio Vatikan pata fatin të isha unë.

Starti dhe ecja e programit shqiptar të Radio Vatikanit

Selia e Shenjtë, nëpër shekuj, vit pas viti e ditë pas dite, ishte interesuar për kombin shqiptar, komb që Vatikanit i kishte dhënë personalitete, deri në kolltukun e Papës. Pra, mund të themi se jo rastësisht Radio Vatikani, që shpesh edhe quhet Radioja e Papës, ndër programet në mbi dyzet gjuhë, ndër më të rëndësishmit e ka radio-programin në gjuhën shqipe, në gjatësi kohore prej njëzet minutash, që transmetohet në çdo mbrëmje dhe ritransmetohet çdo mëngjes. Redaksia shqipe e Radio Vatikanit, e themeluar në vjeshtën e vitit 1951, programin e parë në gjuhën tonë e ka transmetuar më 3 tetor të vitit të përmendur. Në atë mbrëmje të 3 tetorit, zëri i ëmbël i Imzot Zef Shestanit, rreth orës 21:00, kishte “fluturuar” drejt Shqipërisë, duke transmetuar “Udhën e Kryqit”.⁹⁶

Po japim një shkrim të shefit aktual të programit shqiptar të Radio Vatikanit, Dom David Xhuxha, në portalin e redaksisë shqipe, në internet, më 3 tetor 2006. “Është një cak i bukur! Dyzet vjet për të ndihmuar një popull e një Kishë të shtypur; pesëmbëdhjetë vjet shërbimi për rindërtimin e vështirë civil, moral e fetar të këtij populli e të kësaj Kishë. Shqipëria, Kosova e të gjitha trevat shqiptare kanë qenë gjithnjë në zemrën e vëmendjen papëve, që kanë pasuar njëri-tjetrin në këta dhjetëvjeçarë, e ne kemi dhënë dëshminë tonë përmes fjalëve të transmetuara ditë për ditë me mjetin e brishtë, por të fuqishëm, të valëve të radios, i vetmi që edhe regjimi më i ashpër nuk mundi ta bllokonte plotësisht. Radioja e Vatikanit është shumë krenare që mundi ta bënte këtë shërbim në vitet më të errëta të historisë së Shqipërisë, kur vendi që deklaruar zyrtarisht si i vetmi “shtet ateist” në botë.

⁹⁶ https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Vatikani_në_gjuhën_shqipe.

Por e njëjta radio dëshiron të vijojë ta shoqërojë ecjen e shqiptarëve në këtë epokë të re, në të cilën e vetmja paqe në liri, paqja politike e brendshme e ndërkombëtare, paqja shoqërore e, mbi të gjitha, paqësimi i zemrave është ende detyrë që qëndron para nesh. E bëmë këtë me impenjim krejt të posaçëm gjatë krizës së Kosovës, por dëshirojmë ta bëjmë çdo ditë, duke u frymëzuar nga mësimi i lartë i Papës, në bashkim të thellë shpirtëror me Kishën katolike të pranishme në viset e gjuhës shqipe e me të gjithë burrat e gratë veprimtarë e ndërtues të paqes.

Ishte shtatori i vitit 1951, 55 vjet më parë, kur Sekretaria e Shtetit të Qytetit të Vatikanit vendosi që Radioja e Papës të fliste edhe në gjuhën shqipe. Për ngritjen e programit të ri u thirr meshtari shqiptar në mërgim, **Monsinjon Zef Shestani.** Zëri i tij u dëgjua në valët e Radios së Papës më 3 tetor 1951, në orën 21:00, kur nisi transmetimi i parë i programit tonë, me temën simbolike “Udhën e Krygjës”. Populli shqiptar asokohe përshkonte udhën e vet të kryqit nën thundrën e diktaturës komuniste. Ishte një udhë kryqi e mundimshme, reale. Dëmet që i shkaktoi fesë së Krishtit ishin nga më të rëndat që mbahen mend në historinë e kombit shqiptar.

Në kohën kur komunizmi bëri çmos të mbyllte çdo gojë që fliste në emër të Zotit, kur u rrokullisën kumbonat nga kumbonaret e heshtën uratat në kishat e shkallmuara, zëri i Radio Vatikanit vijonte të niste mesazhe përtej perdes së hekurt. U çonte shqiptarëve mesazhet e Atit të Shenjtë, mesazhe ngushëllimi e durese, qëndrueshmërie e ngrohtësie vëllazërore, shprese e paqeje. Telat me gjemba që ndanin Shqipërinë nga bota, nuk mundën ta ndalonin këtë zë të hynte fshehurazi, me kujdes, si një uratë e pëshpëritur pothuajse pa zë, por me gjithë shpirt, ndër shtëpitë e atyre që besonin e shpresonin në Zotin. Selia e Shenjtë nuk i kishte harruar bijtë e vet të masakruar! Bariu i mirë nuk e largonte për asnjë çast vështrimin nga grigja në gojë të ujkut.

Në periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri, Radio Vatikanit në gjuhën shqipe u përpoq të zëvendësonte klerin e zhdukur, ta çonte zërin e Ungjillit në çdo shtëpi, t’i kthente shtëpitë në kisha të vogla dhe prindërit në barinj shpirtërorë të fëmijëve të tyre. Për këtë flet qartë Rruzarja e Shenjtë, që thuhej çdo të shtunë para mikrofonit tonë nga Monsinjon Zef Shestani, Atë Daniel Gjeçaj me një grup murgeshash e laikësh dhe ndiqej pas telave me gjemba nga qindra besimtarë. Monsinjon Zef Shestani, me përshtirësinë e meshtarit dhe vetëmohimin e patriotit të flaktë, përballoi vështirësitë e kohëve të para dhe vuri themelet e programit të gjuhës shqipe.

Më vonë thirri pranë si bashkëpunëtorë Zef Palin, Andrea Shulin, motrën engjëlllore Luçia Laca dhe si bashkëpunëtorë të jashtëm Atë Daniel Gjeçajn, emëruar nga Selia e Shenjtë ‘Përfaqësues shpirtëror i shqiptarëve katolikë të mërguar’.⁹⁷ Mbas Zef Shestanit, në redaksinë shqipe të Radio Vatikanit kishin punuar Zef Pali e Andrea Shuli, motra engjëlllore Luçia Laca dhe ati françeskan e studiuesi i mirënjohur i Fishtës, Atë Daniel Gjeçaj. Pastaj në atë redaksi kanë punuar edhe Gjon Gjomarkaj, Katerina Nushi, Engjëll Koliqi, Dom David Gjugja, Ana Luka e Klaudia Bumçi. Bashkëpunëtorë e jashtëm e kësaj radioje, që nga viti 1990, kur filloi kultivimi i normës së njësuar letrare, ishte edhe stërmbesa e Ismail Qemalit, Nermin Vlora Falaski (Falaschi), etërit bazilianë në Grottaferrata të Romës, Atë Sofron Prence me fretër të tjerë arbëreshë. Bashkëpunëtor i jashtëm i kësaj radioje, për shumë vite, ka qenë edhe i Madhi Ernest Koliqi, i cili kishte hapur katedrën e gjuhës shqipe dhe ishte profesor në Universitetin “La Sapienza” të Romës, mbante gjallë shpirtin arbëresh dhe ishte studiuesi më i denjë i Fishtës e i Konicës.⁹⁸

⁹⁷Portali i internetit i Radio Vatikanit – Programi Shqiptar

http://www.archivioradiovaticana.va/storico/2006/10/03/55vjetori_i_themelimit_programit_shqip_pran_radio-vatikanit/alb-97750

⁹⁸ <http://www.zemrashqiptare.net/news/4611/perkujtojme-ate-daniel-gjecajn-ofm-ne-gjashtevjetorin-e-vdekjes,30> gusht 2008

Siç shpjegohet, më pas edhe në hollësi, në vitet e para, në këtë radio flitej vetëm në dialektin e gegnishtes, për të vazhduar vetëm nga viti 1990 në normën letrare që u përcaktua në vitin 1972. Në vitet e fundit, mbas fitores së demokracisë, nga Shqipëria dhe nga Kosova kjo radio ka angazhuar korrespondentë specialë, edhe duke bashkëpunuar rregullisht me “RTSH”-në dhe me “RTK”-në. Programi i Radio Vatikanit që kryesisht përcjell në botë veprimtarinë e Papës dhe të Selisë së Shenjtë, njofton edhe për veprimtarinë e gjithmbarshme të Kishës Katolike dhe të kishave të tjera në botë, si dhe përcjell mësimet katolike ndër besimtarët, në mbarë botën. Qëllimi i Radio Vatikanit në gjuhën shqipe ishte dhe mbetet përkrahja shpirtërore, morale dhe fetare e besimtarëve të krishterë në të gjitha trojet shqiptare dhe ndërgjegjësimi i kishës universale si edhe ndërmjetësimi i bashkësisë ndërkombëtare për fatet e Shqipërisë⁹⁹.

Në fillim, emisionet shqipe transmetoheshin tri herë në javë me pak minuta, për t’u bërë pastaj të përditshme, në kohëzgjatje prej 20 minutash, çdo mbrëmje, dhe për t’u ritransmetuar herët në mëngjes. Siç u tha edhe më parë, në fillim, nën drejtimin e Imzot Zef Shestani, deri në vitin 1988, në këtë radio kultivohej gegnishtja, që ishte nëndialekti tipik, një shkodranishte e kulluar.¹⁰⁰ Shkodranishtja e ëmbël theksohej sidomos nga Imzot Shestani e Atë Gjeçaj, por edhe nga Motra Luçie Laca, Zef Pali, Andrea Shuli, për t’u dalluar nga profesori dhe ministri historik i Arsimit të Shqipërisë, i Madhi Ernest Koliqi. Që nga viti 1988 e deri në pranverën e vitit 1990, kur redaksia shqipe mbeti nën drejtimin e Gjon Gjomarkajt, aty u kultivua një gegnishte paksa e çoroditur, duke rrëshqitur nëpër nëndialekte apo të folmet krahinore, herë mirditore e dukagjinase, herë kosovare e malësore...

Radio Vatikani flet edhe me normën e njësuar letrare në gjuhën shqipe

Që nga data 7 prill 1990, kur për herë të parë në mikrofonat e Radio Vatikanit foli Engjëll Koliqi, në redaksinë shqipe të asaj radioje filloi të kultivohej norma e njësuar letrare e gjuhës sonë, e cila, megjithë sulmet nga grupacione të ndryshme fanatike, ka mbijetuar e përdoret rrjedhshëm e bukur edhe sot, edhe në studiot e kësaj radioje, por edhe në portalin e Radio Vatikanit në gjuhën shqipe. Në vitet e para, sidomos nga të mëdhenjtë Atë Daniel Gjeçaj dhe Ernest Koliqi, në gegnishten e pastër shkodranishte, kultivohej bukur binomi fishtian FE E ATMÉ (Fe e Atdhe), stil dhe dialekt që e kam përdorur edhe unë, kur kam cituar klasikët tanë, por edhe kur kam pasur të bëj me psalme ose me këngë kishtare shqipe, sepse që të gjitha ishin të shkruara në dialektin verior të gegnishtes.

Përndryshe, të gjitha informacionet dhe kronikat i kam përgatitur edhe shqiptuar në normën e njësuar letrare, duke pasur kujdes edhe në zanoret e hapura e johundore. Më kujtohet si sot, në atë kohë, kolegët nga Radio Prishtina më merrnin në telefon duke bërë shaka me mua, më sa vijon: “O hajvan, a je vlonjat, gjirokastit apo shkodran i Kosovës... çfarë shqiptimi po na bën kështu...?!” Unë shpëtoja nga ato kritika me thumbime, me arsytimin se atëherë i vetmi element që bashkonte kombin tonë ishte norma e njësuar e gjuhës letrare shqipe.

Jam shumë i lumtur që kjo normë në programin shqiptar të Radio Vatikanit përdoret edhe sot, me gjithë disa zbutje e adaptime të të folmeve vendore, gjuhë që kuptohet nga të gjithë shqiptarët, të krishterë dhe jo të krishterë, gegë e toskë, veriorë e jugorë. Duke qenë labe tipike, e mbesa e Ismail Qemalit, zonja Nermin Vlora Falaschi (1921-2004), filloi bashkëpunimin me këtë radio, ku realizonte nga dy emisione në javë, kryesisht për etruskët. Ishte pikërisht kultivimi i normës letrare të njësuar që ia hapi dyert e bashkëpunimit zonjës Nermin Vlora, e cila, me emisionet e veta speciale e shumë të rëndësishme, ua mundësoi dëgjuesve të Radios së Papës që të njiheshin me etruskët, ilirë në Gadishullin Apenin, nga të cilët supozohet se e kanë prejardhjen afër dy të tretat e kombit italian.

⁹⁹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Vatikani_në_gjuhën_shqipe

¹⁰⁰ Portali në internet i redaksisë shqipe https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Vatikani_në_gjuhën_shqipe

Siç më ka thënë ish-ministri italian i Mbrojtjes, Beniamino Andreatta, në mars 1999, me rastin e mbledhjes së Grupit të Kontaktit për Kosovën, në Romë ku u vendos që aeroplanët e NATO-s që do të bombardonin Serbinë dhe caqet ushtarake serbe në Kosovë, të ngriheshin nga bazat ushtarake italiane, ai vetë ishte me origjinë shqiptare dhe mbi dy të tretat e kombit italian janë me origjinë shqiptare.



Nermin Vlora Falaschi, 1921-2004



**Redaksia në vitin 1990 – Katerina Nushi,
Engjëll Koliqi, Gjon Gjomarkaj, Dom David Gjugja**



**Engjëll Koliqi
në Sheshin e Shën Pjetrit, 1990**

Përfundime

- Selia e Shenjtë, përmes papëve, gjithmonë ka drejtuar vëmendje speciale dhe është kujdesur përherë për kombin tonë, për Shqipërinë.
- Përkujdesja e Selisë së Shenjtë dhe e Papës për shqiptarët është sheshuar në vjeshtën e vitit 1951, pikërisht më 3 tetor të atij viti, kur u hap programi shqiptar në Radio Vatikan.
- I pari që shqip foli dhe u dëgjua në mbarë botën, ishte meshtari ynë i devotshëm e patrioti Imzot Zef Shestani.
- Gati katër dekada në këtë radio shqip, flitej vetëm gegnisht, kryesisht në të folmen shkodranishte, duke qenë se shumica e redaktorëve në ato vite ishin nga Shkodra.
- Në pranverën e vitit 1990, për herë të parë në Radio Vatikan gjuha jonë u fol me normën letrare të njësuar, sipas vendimit të Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, në Tiranë.
- I pari ishte prof. Engjëll Koliqi që foli me normën letrare të njësuar në këtë radio.
- Duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha historike në Kosovë e në Shqipëri, që nga viti 1990, drejtori i përgjithshëm i Radio Vatikanit, Atë Pasquale Borgomeo, kishte lejuar që në gjuhën shqipe, vetëm një e treta e emisionit t'i kushtohej aktivitetit të Papës e të Kishës, kurse dy të tretat kombit dhe çështjes kombëtare e shoqërore, në Kosovë dhe në Shqipëri.

➤ Radio Vatikani flet shqip nga 20 minuta në ditë, çdo mbrëmje në orën 18:30, dhe ritransmetohet çdo mëngjes në orën 4:30.

➤ Deri në vitin 1988 programi shqiptar në Radio Vatikan u drejtua nga Imzot Zef Shestani, pastaj deri në vitin 1992 nga mirditori Gjon Gjomarkaj e që nga viti 1992 drejtohet nga prifti kosovar Dom David Gjugja.

➤ Në periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri, Radio Vatikani në gjuhën shqipe u përpoq të zëvendësonte klerin e zhdukur, ta çonte zërin e Ungjillit në çdo shtëpi, t'i kthente shtëpitë në kisha të vogla dhe prindërit në barinj shpirtërorë të fëmijëve të tyre.

Referencat

- [1]. Portal interneti-https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Vatikani_nëgjuhën_shqipe
- [2]. Potrtal interneti <http://www.zemrashqiptare.net/news/4611/perkujtojme-ate-daniel-gjecajn-ofm-ne-gjashtevjetorin> e vdekjes, 30 gusht 2008
- [3]. David Gjugja, Papa në Shqipëri 25 prill 1993, Radio Vatikani dhe Drita, Gorle (Bergamo), 1995
- [4]. Engjëll Koliqi, Miku i Madh i Shqiptarëve, Rugova Art & Drita, Prishtinë, 2013
- [5]. Engjëll Koliqi, Ylli i Dardanisë rrezaton tokë e qiell, Rugova Art, Prishtinë, 2010
- [6]. Engjëll Koliqi, La Stella di Dardania irradio cielo e terra. Trisauro, Kalabri, 2010
- [7]. Engjëll Koliqi, Dr. Ibrahim Rugova arkitekt i Dardanisë së Re – Republika e Kosovës, Rugova Art, Prishtinë, 2011
- [8]. Portali i internetit i Radio Vatikanit – Programi Shqiptar http://www.archivioradiovaticana.va/storico/2006/10/03/55vjetori_i_themelimit_programit_shqip_pran_radio_vatikanit/alb-97750
- [9]. Engjëll Koliqi, Gjurmëve të martirëve, Rugova Art, Prishtinë, 2015